



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1823 Prot.

Tiranë, më 27/07/2022

V E N D I M

Nr. 22, datë 27.07.2022

P Ë R

MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT DHE TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”, PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, SI DHE PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE” ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023 NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, shkronja c, vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 26, pika 3, si dhe vendimin nr. 14, datë 21.07.2022 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e regjistrimit për programet e studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2022 – 2023, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë tarifat vjetore të shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” me kohë të plotë, për vitin akademik 2022 – 2023 sipas tabelave nr. 2, 3 dhe 4 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Tarifa e shkollimit paguhet nga studentët në masën, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

4. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
5. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve, i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij (3 vjet cikli i parë dhe 5 vjet studimet e integruara), do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2022 - 2023.
6. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të dytë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave", i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohezgjatjes normale të studimit, do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2022 - 2023.
7. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e parë të studimeve dhe programin e integruar të studimeve, kryhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të dimrit.
8. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, kryhet e ndarë në 2 (dy) këste. Kësti i parë të paguhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të dimrit dhe kësti i dytë paguhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të verës.
9. Në situata objektive që e bëjnë të pamundur respektimin e afateve të përcaktuara për pagesën e tarifës së shkollimit, njësitë kryesore të kenë mundësi veprimi për metodologjinë dhe afatet e pagesave.
10. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe fakultetet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI



Tabela nr. 2

Tarifat e Shkollimit në programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor për vitin akademik 2022-2023 :

Nr.	Fakulteti	Programi i Studimit	në lekë	
			Tarifa, programi i parë për 60 Kredite /1 vit	Tarifa, programi i dytë për 60 Kredite / 1 vit
1	Fakulteti Arkitekturës dhe Urbanistikës	Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn	40,000	203,690
2	Fakulteti Inxhinierisë Elektrike	Bachelor në Inxhinieri Elektrike, profili Energjitikë	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizim		
		Industrie	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Mekanikë	25,000	203,690
3	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatikë	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe e Gazit	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Mekanike	25,000	203,690
4	Fakulteti Inxhinierisë Mekanike	Bachelor në Inxhinieri Tekstile dhe Modë	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Materiale	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Ekonomike	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Matematike	25,000	203,690
5	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Bachelor në Inxhinieri Fizike	25,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi	35,000	203,690
6	Fakulteti Inxhinierisë së Ndërtimit	Bachelor në Inxhinieri Mjedisi	25,000	203,690
		Bachelor në Gjeodezi	25,000	203,690
		Bachelor në Hidroteknikë	25,000	203,690
7	Fakulteti Teknologjisë Informatike	Bachelor në Inxhinieri Elektronike	30,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Informatike	30,000	203,690
		Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacionit	30,000	203,690

DREJTORI I DREJTORISË EKONOMIKE

ELVANA NDRECA

ADMINISTRATORI

BESMIR ALI



Nr	Fakulteti	Programi i Studimit	Tarifa për 60 Kredite/ 1 vit	Tarifa për 60 Kredite/ 1 vit
7	Fakulteti Arkitekturës Urbanistikë	Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Arkitekt	40000	203,690
		Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Urbanist	40000	203,690

DREJTORI I DREJTORISË EKONOMIKE

ELVANA NDRECA

ADMINISTRATORI

BESMIR ALI

